




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, nenit 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 36. paragrafi 36.2 shkronja d), lidhur me nenin 44, të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

për aprovimin e planit të punës të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton planin e punës të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i punës i Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale për vitin 2022, me Nr. te protokollit 01-035/02-593 e datës: 08.06.2022.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi i Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale për vitin 2022.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Kryesuesit të Komitetit për Shëndetësi...; dhe
3. Arkivit.


KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Prokuror - Publikim: 10.06.2022	Mod.		
Numri i organit: 01-035/02-001	Numri i aktit: 035/02-001	Chetori: Prillor	Vitë: Vitina



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 35, paragrafi 2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë paraqet këtuesi i Kuvendit të

PROPOZIM VENDIM PROPOZIM VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE PËR VITIN 2022 PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE PËR VITIN 2022

Neni I Neni I

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, i PROPOZON Kuvendit, që ta shqyrtoj dhe aprovoj Planin e Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale për vitin 2022.

Neni II Neni II

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Plani i Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale për vitin 2022.

Neni III Neni III

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset kryesuesi i Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

Neni IV

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.


KRYESUESI I KUVENDIT

Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

KOMITETI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

PLANI I PUNËS

PËR VITIN

2022

Viti

P Ë R M B A J T J A:

- Hyrja
- Aktivitetet e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Prezantimi i planit të punës për vitin 2022
- Kalendari i aktiviteteve për vitin 2022

1.HYRJE

Plani i punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2022 është përpiluar me qëllim të krijimit të një varg aktiviteteve me të cilat detajizohet puna dhe veprimet e këtij Komiteti si trup ndihmës i Kuvendit Komunal.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2022

Plani i punës për vitin 2022 është përgatitur nga anëtarët e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , në përputhje me rregulloren për kompetenca , përgjegjësi dhe punën e Komiteteve të Përhershme si trupa të Kuvendit të Komunës së Vitisë

Komiteti për Shëndetësi si dhe Mirëqenie Sociale brenda kompetencave të përcaktuara nga rregullorja ka për qëllim që të ndihmojë Kuvendin e Komunës në marrjen e vendimeve të rëndësishme profesionale,në procesin e ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve sociale.

Plani përmban informata rreth aktiviteteve që ky Komitet do ti zhvilloj gjatë vitit 2022

- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale jep mendime, propozime, vërejtje dhe rekomandime që i adreson KPF-së për diskutim dhe miratim në Kuvendin Komunal.
- Shqyrton dhe propozon zgjedhje në rastet e projekteve lidhur me buxhetin për shëndetësi, në kuptim të percaktimit të vijës së përhershme buxhetore, harmonizimit të strategjive zhvillimore të shëndetësisë për sektor të ndryshëm në Komunën e Vitisë.
- Përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë rekomandimet e dalura nga Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të cilat miratohen nga Kuvendi Komunal i Vitisë.
- Monitoron zbatimin e planeve Komunale, të miratuara nga ana e Kuvendit Komunal,si dhe kryen punë të tjera që dalin nga fusha e Shëndetësisë brenda Komunës.
- Jep propozime për rregullore të ndryshme në lëminë e Shëndetësisë.
- Jep mendime dhe ide rreth iniciativave që i ndërmer Kryetari i Komunës apo Kuvendi i Komunës në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
- Komiteti për Shëndetësi dhe Mireqenie Sociale ,e përkrahë dhe mirëpret bashkëpunimin me Organizatat jo Qeveritare partnere të KK,dhe bashkëpunimin me qytetarët e Komunës së Vitisë.

- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale çdo fundvit duhet të përgadis raportin vjetorë për vitin aktual, si dhe kalendarin e aktiviteteve për vitin e ardhshëm, të cilat do të përcjell në Kuvendin e Komunës.
- Plani i punës do të përcillet organeve përgjegjëse si dhe të gjithëve anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe MS.

2.1. Takimet e rregullta të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Në parim me rregulloren për Komitetet e përhershme të Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komiteti për SHMS gjatë vitit 2022 do të mbajë nga një takim të rregullt në muaj, në të cilat takime do të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komitetit ku sipas nevojës komiteti do të mbaj edhe takime tjera.

2.2. Monitorimi i marrjes parasysh të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve.

Për këtë qëllim do të organizojm takime me zyrëtarët dhe drejtoritë përkatëse të Komunës së Vitisë.

2.3. Prezantimi i raportit vjetor për vitin vijues.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale çdo fundvit do të përgaditë raportin vjetor në të cilin do të përfshihen të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit. Raporti vjetor do të prezantohet në Kuvendin e Komunës.

2.4. Prezantimi i planit të punës për vitin vijues

KSHMS çdo fundvit do të përgadis planin e punës për vitin vijues, i cili do të prezantohet në Kuvendin e Komunës më së largu në muajin Dhjetor.

3. KALENDARI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2022

Muaji	Qëllimi i takimit	Pjesmarrësit
Qershor	Përgaditja e planit të punës i komitetit për vitin 2022	Anëtarët e Komitetit për SHMS. Drejtori i DSHMS-së Drejtori i QKMF-së Përgjegjësit e njësive në QKMF.
Korrik	Raport për realizimin e Kontrollave sistematike të nxënësve të shkollave fillore të Komunës së Vitisë për vitin 2022.	Anëtarët e Komitetit për SHMS Drejtori i DSHMS-së Drejtori i QKMF-së

Gusht	Raporti mbi vaksinimin e fëmijëve dhe nxënësve të Komunës së Vitisë si dhe vaksinimi i qytetarëve me vaksinën kundër gripit sezonal dhe vaksinën Anti Covid-19.	Anëtarët e Komitetit për SHMS Shefi i Vaksinimit Drejtori i DSHMS-së Drejtori i QKMF-së
Shtator	Plani për realizimin e Kontrollave sistematike të nxënësve të shkollave fillore të Komunës së Vitisë për vitin 2022-2023.	Anëtarët e Komitetit për SHMS Drejtori i DSHMS-së Drejtori i QKMF-së
Tetor	Vizitë në QMF, Viti dhe Pozheran. Vizitë të gjitha AMF-ve Diskutim mbi obligimet e punës, sfidat dhe planet në të ardhmen	Anëtarët e Komitetit për SHMS Drejtori i QKMF-së Drejtori i DSHMS-së
Nëntor	Prezantimi i raportit të projektit për Nëna dhe Fëmijë në kuader të QKMF.	Anëtarët e Komitetit për SHMS Kordinatorja e projektit për Nëna dhe Fëmijë Drejtori i QKMF-së Drejtori i DSHMS -së
Dhjetor	Raporti i punës së Komitetit për SHMS për vitin 2022 Plani i punës për vitin 2023	Antarët e KSHMS

Kryesuese e KSHMS-ës

Valentina Mehmeti

